

## Kombetarja vijon pergatitjet ne France

nga Administrator

E martë, 07 Qershor 2016 14:45

---



Kombetarja shqiptare ka vijuar pergatitjet per Euro 2016. Sot paradite ekipi eshte grumbulluar ne qendren stervitore Yves-Le Jannou te Perros-Guirec. Ne ditën e dyte lojtaret kane bere ushtrime fizike dhe shpejtesie.

I vetmi lojtar qe ka munguar ne stervitjen e mengjesit ka qene mbrojtesi Mergim Mavraj. Ai ka qendruar pushim duke bere stervitje te lehte ne menyre qe te mos pesoje ndonje demtim. Pas pak ne oren 17:00 do te mbahet konferenca per shtyp e radhes e kombetares dhe pas saj rreth ores 17:30 do te zhvillohet stervitja e pasdites.